



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201401550/5

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandojmë dërgimin e plotë të kopjeve të dokumentacionit të dosjes së pensionit të pleqërisë të shtetases S.P, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme.*

**Drejtuar :** **Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

**GJIROKASTËR**

**Zoti Drejtor,**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi S.P, banues në Përmet, lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentave zyrtare të kërkuara nga ana e tij.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë, ka kërkuar pranë institucionit që Ju drejtoni kopje të dokumentacionit të dosjes e pensionit të tij të pensionit, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

E drejta e informimit është e garantuar në nenin 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku në pikën 2 të tij, thuhet shprehimisht se:

*“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”.*

Duhet theksuar se e drejta e informimit është një nga të drejtat e afirmuara në akte të rëndësishme ndërkombëtare siç edhe, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 19), apo Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (neni 10).

Në nenin 3 të Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktohet se:

*“Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qënë i detyruar të shpjegojë motivet. Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe”.*

Neni 4, i ligjit të sipërcituar jep kuptimin dhe përcaktimin se kur mund të kufizohet dhënia e dokumentave zyrtare dhe me konkretisht;

*“Nëse informacioni i kërkuar për një dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i lëshon kërkuarit një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e mosdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të të cilave ai mund ta kërkojë atë.*

*Nëse kufizimi është vetëm për një pjesë të të dhënave të dokumentit zyrtar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit”.*

Referuar rastit konkret, konstatojmë se:

-Në përputhje me nenin 7, të Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999, të sipërcituar, ku thuhet shprehimisht se: *“Kërkuarit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkohet të informohet”*, ankuesi ka paraqitur në përputhje me ligjin, kërkesë zyrtare për marrje informacioni dhe kopje dokumentacioni zyrtar.

-Kërkesës zyrtare, për informacionin dhe kopjen e dokumentacionit të kërkuar prej ankuesit, nga ana e institucionit tuaj, nuk i është kthyer përgjigje me shkrim, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10, të Ligjit nr. 8503 datë 30.06.1999, në të cilin thuhet shprehimisht se:

*“Autoriteti publik vendos për mospranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës brenda 15 ditëve nga depozitimi i saj. Në rast të mospranimit të kërkesës, përgjigja negative, e plotë apo e pjesshme, jepet e arsyetuar, me shkrim nga autoriteti publik”.*

Pra, sa më lart, arrihet në konkluzionin se kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës për t’u informuar me të gjithë dokumentat përkatës zyrtare, të kërkuar nga ana e ankuesit.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, të paragrafit 2, të nenit 3, si dhe të paragrafit të parë, të nenit 18, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”*, në të cilët thuhet se: *“Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe”*, *“Avokati i Popullit kujdeset për zbatimin e këtij ligji...”*,

## **R E K O M A N D O J M Ë**

*Dërgimin e plotë të kopjeve të dokumentacionit të dosjes së pensionit të pleqërisë të shtetases S.P, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme.*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se;

*“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,*

lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**